



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2020:165304

Datë: 18.03.2024

Numri i dokumentit: 05466734

C.nr.1692/2020

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Uran Zogaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit R.K. nga fshati Komuna e Malishevës, të cilin me autorizim e përfaqëson av. B.Xh. nga Malisheva, kundër të paditurës Q.R.K., M.P.B. Drejtoria e P.K., me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, Prishtinë, me objekt të kontestit kompensimi i dëmit material dhe jomaterial, vlera e kontestit 47,886.16 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, në prani të paditësit, të autorizuarës së paditësit dhe në mungesë të të paditurës, më datë 08.02.2024 mori, ndërsa më datë 18.03.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit R.K. nga fshati Komuna e Malishevës, kundër të paditurës Q.R.K., M.P.B. Drejtoria e P.K. me seli në Prishtinë.

II. DETYROHET e paditura, që paditësit, t'ia paguajë shumat si në vijim:

- a. Në emër të kompensimit të dëmit material- kompensimit të diferencës së pagave neto për periudhën kohore nga data 18.07.2010 deri më 08.10.2010 t'ia paguajë shumën prej 1,039.61 euro dhe për periudhën kohore nga data 05.12.2014 deri më 22.10.2020 t'ia paguajë shumën prej 11,846.55 euro apo t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 12,886.16 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë më datë 26.11.2020 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 (shtatë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të detyrueshëm.
- b. Në emër të kontributit pensional të punëdhënësit dhe kontributit pensional të të punësuarit, për periudhën kohore nga data 18.07.2010 deri më 08.10.2010, të paguhet shuma prej 113.92 euro dhe për periudhën kohore nga data 05.12.2014 deri më 22.10.2020, të paguhet shuma prej 1,275.14 euro apo të paguhet shuma e përgjithshme prej 1,389.06 euro, përmes Administratës Tatimore të Kosovës, në fondin e trustit pensional të të punësuarit- paditësit, në afat prej 7 (shtatë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të detyrueshëm.
- c. Në emër të tatimit në pagë, për periudhën kohore nga data 18.07.2010 deri më 08.10.2010, të paguhet shuma prej 42.54 euro dhe për periudhën kohore nga data 05.12.2014 deri më 22.10.2020, të paguhet shuma prej 267.24 euro apo të paguhet shuma e përgjithshme prej 309.78 euro, në llogari të Administratës Tatimore të Kosovës - Buxhetit të Republikës së Kosovës, në afat prej 7 (shtatë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të detyrueshëm.

- d. Në emër të kompensimit të dëmit jomaterial për shkak të cenimit të personalitetit dhe nderit, për dhimbjet shpirtërore të përjetuara, t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 10,000.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga dita e marrjes së aktgjykimit më datë 01.02.2024 e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura, që paditësit, t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore, në shumën e përgjithshme prej 1,180.00 euro, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të detyrueshëm.

IV. REFUZOHET e pa bazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, lidhur me kompensimin e dëmit jomaterial, përtej shumës së gjykuar sikur në pikën II., nën pikën d. të dispozitivit të aktgjykimit deri në shumën e kërkuar prej 35,000.00 euro, përkatësisht shuma prej 25,000.00 euro.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi R.K. nga fshati Komuna e Malishevës, të cilin me autorizim e përfaqëson av. B.Xh. nga Malisheva, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padinë, kundër të paditurës Q.R.K., M.P.B. Drejtoria e P.K., me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, Prishtinë, me objekt të kontestit kompensimi i dëmit material dhe jomaterial.

Në padi, është theksuar se paditësit i është shkaktuar dëm material dhe jomaterial, për shkak të procedurës disiplinore të zbatuar në mënyrë të padrejtë nga e paditura ndaj paditësit. Me vendimin e të paditurës, paditësi është degraduar nga grada e rreshterit në atë të policit, nga të cilat vendime i njëjti ka pësuar zvogëlim të pagës dhe dëm jo material, pasi që të njëjtit i janë cenuar vlerat morale, Andaj, ka propozuar që të të aprovohet e bazuar kërkesëpadia e paditësit dhe të detyrohet e paditura në kompensimin e dëmit material dhe jomaterial ndaj paditësit dhe në kompensimin e shpenzimeve procedurale.

Me parashtrësën e datës 14.02.2024 dhe në fjalën përfundimtare, e autorizuar e paditësit ka precizuar kërkesëpadinë në aspektin objektiv, duke kërkuar që të detyrohet e paditura, që paditësit në emër të kompensimit të dëmit material t'ia paguajë shumën prej 12,886.16 euro dhe në emër të dëmit jomaterial t'ia paguajë shumën prej 35,000.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive dhe të detyrohet e paditura në kompensimin e shpenzimeve të procedurës në shumë prej 1,180.00 euro

Me aktvendimin C.nr.1692/2020 e datës 07.03.2024, gjykata ka lejuar ndryshimin e padisë së paditësit në aspektin objektiv, sipas parashtrësës së datës 14.02.2024.

Në përgjigjen në padi, e paditura përmes të autorizuarës së saj ka theksuar se e kontestojnë në tërësi kërkesëpadinë e paditësit. Po ashtu, e paditura thekson se asaj nuk i janë dorëzuar padia dhe prova e në mungesë të tyre nuk mund të deklarohet lidhur me këtë çështje juridike. Andaj, ka propozuar që të caktohet shqyrtimi kryesor dhe të detyrohet paditësi në përmbushjen e obligimit lidhur me padinë dhe provat.

Gjatë shqyrtimit kryesor si dhe në fjalën përfundimtare, e autorizuar e paditësit ka deklaruar se me pa mëdyshje është provuar se paditësit i është shkaktuar dëmi material dhe jomaterial, nga vendimet e padrejta të saj dhe ky fakt nuk mund të kontestohet, andaj është përgjegjësi e të paditurës që të kompensojë këtë dëm ndaj paditësit. Dëmi që ka pësuar paditësi vërtetohet nga ekspertizat gjyqësore, nga ajo financiare dhe psikiatrike, kështu që bazuar në format dëmit që ka pësuar paditësit, kërkesa e tij është e bazuar. Andaj, ka propozuar që të aprovohet e bazuar kërkesëpadia e paditësit, të detyrohet e paditura në kompensimin e dëmit material dhe jomaterial në shumën e përgjithshme prej 47,886.16 euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive dhe në kompensimin e shpenzimeve të procedurës në shumën e përgjithshme prej 1,180.00 euro, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

Shqyrtimin kryesor në këtë çështje juridike, gjykata e ka mbajtur në mungesë të të paditurës, në përputhje me nenin 423 par. 4 e Ligjit për procedurën kontestimore (LPK), pasi e njëjta është ftuar rregullisht, por që mungesën nuk e ka arsyetuar.

Gjendja faktike e vërtetuar

Për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat si në vijim: ekspertizën financiare të datës 28.09.2023, pranuar në gjykatë më datë 29.09.2023, punuar nga eksperti financiar F.D. nga Prizreni; deklarin e ekspertit financiar F.D. ekspertizën psikiatrike të datës 10.01.2024, pranuar në gjykatë më datë 12.01.2024, punuar nga eksperti psikiatër Dr. N.F. deklarin e ekspertit psikiatër Dr. N.F. aktgjykimin Ac.nr.3416/17 i datës 23.09.2020; aktgjykimin C.nr.1/15 i datës 21.01.2017 dhe i ekzekutueshëm më datë 26.10.2020; vërtetimin e punësimit numër reference 05/1-03/314/2012 i datës 03.04.2012; kontratën e punës për paditësin R.K. e datës 15.01.2013; vendimin për ndërprerje të suspendimit me pagesë numër reference 059/NSP/DP/2010; urdhëresën për ekzekutimin e vendimit numër reference 07/1-01SAP-P/5784 e datës 20.10.2020; urdhëresën për ekzekutimin e vendimit numër reference 07/1-01A/8867 e datës 08.12.2014.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për procedurën kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se:

- kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar.

Nga leximi i ekspertizës financiare të datës 28.09.2023, pranuar në gjykatë më datë 29.09.2023, punuar nga eksperti financiar F.D. nga Prizreni, vërtetohet se shuma totale e pagave neto nga data 18.07.2010 deri më 08.10.2010 është prej 1,039.61 euro, kontributi pensional për punëdhënësin në shumë prej 56.96 euro, kontributi pensional për punëmarrësin në shumë prej 56.96 euro dhe tatimi në pagë prej 42.54 euro apo pagat bruto në këtë periudhë në shumë prej 1,139.10 euro. Po ashtu, nga ekspertiza e lartcekur vërtetohet se shuma totale e pagave neto nga data 05.12.2014 deri më 22.10.2020 është prej 11,846.55 euro, kontributi pensional për punëdhënësin në shumë prej 637.57 euro, kontributi pensional për punëmarrësin në shumë prej 637.57 euro dhe tatimi në pagë prej 267.24 euro apo pagat bruto në këtë periudhë në shumë prej 12,751.36 euro. Nga ekspertiza financiare e datës 28.09.2023, vërtetohet se shuma totale e kompensimit të pagave neto është në vlerë prej 12,886.16 euro (1,039.61+11846.55).

Ekspertit financiar F.D. gjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë ekspertizës financiare të datës 28.09.2023. Gjithashtu, ka shtuar se obligimi për raportimin dhe pagesën e kontributeve pensionale dhe tatimit në pagë është e punëdhënësit- të paditurës, për këtë arsye në tabela janë specifikuar paga bruto dhe neto. Pagesa, përkatësisht kompensimi i kontributeve pensionale për të paditurën dhe paditësin dhe tatimit në pagë, për secilin muaj bëhet korrigjimi nga punëdhënësi- e paditura dhe nga ajo rrjedh obligimi i kontributit pensional dhe tatimit në pagë. Pra, kontributet pensionale paguhen përmes Administratës Tatimore të Kosovës, në llogarinë personale të fondit pensional të trustit, ndërsa tatimi në pagë paguhet në llogari të Administratës Tatimore të Kosovës, përkatësisht buxhetit të Republikës së Kosovës.

Nga leximi i ekspertizës psikiatrike të datës 10.01.2024, pranuar në gjykatë më datë 12.01.2024, punuar nga eksperti psikiatër Dr. N.F. u vërtetua se si pasojë e degradimit në pozitë të bërë nga e paditura, paditësit i ka shkaktuar gjendje jo të mirë shëndetësore dhe shpirtërore, prej së cilës ka pasur ankth, pasiguri, mërzitje, vështirësi në përballimin e situatave jetësore, mendime negative dhe tërheqje sociale. Po ashtu, nga ekspertiza psikiatrike vërtetohet se paditësi ka përjetuar dhimbje shpirtërore të intensitetit të lartë në dy muajt e parë nga momenti i degradimit, e shprehur në formë të shfaqjes së emocioneve negative si turp, mërzitjeve, vështirësive të gjumit, humbjes së oreksit, ndjenjës së vlerës së ulët të vetvetes dhe poshtërimit, dhimbje shpirtërore të intensitetit të mesëm që ka vazhduar për tre muaj në formë të ankthit, nervozizmit, iritabilitetit, ndjeshmërisë së tepruar, indisponimit dhe përfshirjes së sikletshme në aktivitete familjare dhe shoqërore dhe dhimbje shpirtërore të intensitetit të ulët që kanë vazhduar deri në kryerjen e plotë të anulimit të vendimit degradues nga gjykata, që është shprehur në formë të mendimeve negative, anktheve të kohëpaskohshme dhe dëshpërimit.

Eksperti psikiatër Dr. N.F.j në shqyrtim kryesor deklaroi se në raportin me shkrim të paraqitur pranë gjykatës, kam përfshirë edhe nivelet dhe intensitetin e përjetimit të dhimbjes shpirtërore të paditësit, ku është marrë parasysh edhe fakti se paditësi ka qenë i ndjekur penalisht lidhur me këtë çështje juridike dhe në përjetimin e dhimbjeve shpirtërore, është përfshirë edhe lëndimi i integritetit moral. Në fund, eksperti psikiatër theksoi se nga përvoja e tij si ekspert gjyqësor i psikiatrisë, ka pasur raste të ndryshme kur një person ka përjetuar edhe dhimbje shpirtërore, si pasojë e një vendimi të kundërligjshëm të marrë ndaj tij. Rastet janë të ndryshme, sepse në disa raste ka pasur edhe ndjekje nga organet gjyqësore të personave, largim nga puna, suspendim nga puna dhe raste tjera. Në rastin konkret, për shkak të një degradimi që gjykata ka qenë i pabazuar, atëherë mund të konstatohet se ekziston përjetimi i dhimbjes shpirtërore, sepse çdo vendim i padrejtë, qoftë në një institucion apo në ndonjë vend të punës, mund të sjellë lëndim shpirtëror të një person dhe mund të zgjasë derisa të rivendoset e drejta e atij personi. Po ashtu, nga praktika profesionale dhe literatura profesionale, njihet kjo e drejtë e përjetimit dhe kompensimit të dhimbjes shpirtërore.

Nga leximi i aktgjykimit Ac.nr.3416/17 i datës 23.09.2020 e Gjykatës së Apelit të Kosovës, është vërtetuar se është refuzuar e pabazuar ankesa e të paditurës Q.K., Ministria e Punëve të Brendshme-P.K. në Prishtinë dhe Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil C.nr.1/15 i datës 21.03.2017, është vërtetuar.

Nga leximi i aktgjykimit C.nr.1/15 i datës 21.01.2017 i Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil dhe i ekzekutueshëm më datë 26.10.2020, vërtetohet se është aprovuar e bazuar kërkesëpadia e paditësit R.K. dhe janë anuluar Vendimi i Komisionit të Brendshëm Disiplinor i të paditurës numër 854/KBD/214 i datës 30.10.2014 dhe Vendimi i Komisionit për Ankesa dhe Shpërblime i të paditurës numër 274-KA-D/2014 i datës

26.11.2014, me numër protokollit 637-3 i datës 03.12.2017 dhe është detyruar e paditura që të pranojë këtë fakt dhe t'ia kompensojë paditësit shpenzimet e procedurës.

Nga leximi i vërtetimit të punësimit numër reference 05/1-03/314/2012 i datës 03.04.2012, vërtetohet se paditësi është i punësuar pranë të paditurës me orar të plotë, nga data 22.05.2000 dhe paga momentale e tij është 518.65 euro.

Nga leximi i kontratës së punës për paditësin R.K. e datës 15.01.2013, është vërtetuar se paditësi është i punësuar pranë të paditurës në gradën Rreshter, në pozitën Mbikëqyrës i njësitit patrullues kufitare, në periudhë të pacaktuar kohore, në pagën themelore prej 338.65 euro dhe fillimi i punës është bërë nga data 22.05.2000.

Nga leximi i vendimit për ndërprerje të suspendimit me pagesë numër reference 059/NSP/DP/2010, është vërtetuar se e paditura ka marrë vendim për ndërprerje të suspendimit me pagesë, pasi që masa suspendim me pagesë ka përfunduar dhe paditësi është dashur të paraqitet në vendin e punës më datë 08.10.2010.

Nga leximi i urdhëresës për ekzekutimin e vendimit numër reference 07/1-01SAP-P/5784 e datës 20.10.2020, u vërtetua se është anuluar Urdhëresa për ekzekutimin e vendimit “Degradim nga grada Rreshter në gradën Zyrtar policor”, me referencë: 07/1-01A/8867 e lëshuar nga Drejtoria e Personelit më datë 08.12.2014.

Nga leximi i urdhëresës për ekzekutimin e vendimit numër reference 07/1-01A/8867 e datës 08.12.2014, është vërtetuar se paditësi është degraduar nga grada Rreshter në gradën Zyrtar policor.

Baza ligjore

Me nenin 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcaktohet se “çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur”. Pastaj, në nenin 41 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut parashihet që “kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe, nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar”.

Në vazhdim, me nenin 154 par. 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) nr. 29/78 i datës 30.03.1978, përcaktohet që “kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”. Pastaj, me nenin 155 të LMD-së parashihet që “dëmi është pakësim i mjeteve shoqërore, respektivisht i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe parandalimi i shtimit të tyre (përfitimi i munguar), si dhe shkak i tjetrit të dhimbjes ose të frikës fizike apo psikike (dëmi jomaterial)”.

Në nenin 185 par. 1 të LMD-së ceket se “personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e ekzistuar para se të shkaktohej dëmi”. Ndërsa, me nenin 189 par. 1 të LMD-së thuhet se “i dëmtuari ka të drejtë si për kompensimin e dëmit të thjeshtë ashtu edhe për kompensimin e fitimit të munguar”.

Po ashtu, me Rregulloren nr. 2001/27 për ligjin themelor të punës në Kosovë të datës 08.10.2001, në nenin 13, 14 dhe 15, janë paraparë të drejtat e të punësuarit që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, duke përfshirë edhe të drejtën në pagë.

Në vazhdim, me nenin 199 të LMD-së theksohet që “në rast shkeljes të së drejtës së personit gjykata mund të urdhërojë shpalljen e aktgjykimit me shpenzim të dëmtuesit, ose shpalljen e ndreqjes së gabimit apo të urdhërojë që dëmtuesi ta tërheqë deklaratën me të cilën është bërë shkelja, ose diçka tjetër me të cilën gjë mund të realizohet qëllimi që arrihet me kompensim”. Pastaj, me nenin 200 par. 1 të LMD-së është paraparë se “për dhimbjet e pësuar fizike, për dhimbjet e pësuar shpirtërore, për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të jetës të prishjes, të shkeljes së nderit ose të lirisë, të vdekjes së personit të afërm si dhe për frikën gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit për frikën dhe zgjatja e tyre justifikon këtë, do të gjykojë kompensim të drejtë në të holla, pavarësisht nga kompensimi i dëmit material dhe nga mungesa e dëmit material”. Më tutje, në paragrafin 2 të nenit të lartcekur të LMD-së thuhet se “me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jomaterial si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh për rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit shërben ky kompensim e gjithashtu edhe për faktin se mos të u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”.

Ndërsa, me nenin 7 par. 1 të Ligjit për procedurën kontestimore (LPK) është paraparë se “palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”. Me nenin 2 par. 2 të LPK-së është paraparë se “gjykata i zbaton rregullat e të drejtës materiale sipas çmuarjes së saj dhe nuk është e lidhur me thëniet e palëve që kanë të bëjnë me të drejtën materiale”.

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Në këtë drejtim, gjykata pas vlerësimit të provave të administruara gjatë shqyrtimit kryesor, të propozuara nga palët ndërgjyqëse, ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar.

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk rezulton të jetë kontestuese se paditësit R.K. i është shqiptuar masa disiplinore “Degradim” nga grada Rreshter në pozitën Zyrtar Policor. Po ashtu, kontestuese nuk rezulton të jetë fakti se masa disiplinore e lartcekur është anuluar sipas vendimit gjyqësor dhe e paditura ka bërë ekzekutimin e këtij vendimi, duke kthyer paditësin në gradën Rreshter.

Kontestuese në këtë çështje juridike ishte nëse paditësit i takon e drejta e kompensimit të dëmit material për pagesën e pagave, përkatësisht diferencave të tyre dhe dëmit jomaterial, të shkaktuar si pasojë e shqiptimit të masës disiplinore të të paditurës.

Në këtë drejtim, përmes aktgjykimit C.nr.1/15 i datës 21.01.2017 i Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil dhe i ekzekutueshëm më datë 26.10.2020, rezulton Vendimi i Komisionit të Brendshëm Disiplinor i të paditurës numër 854/KBD/214 i datës 30.10.2014 dhe Vendimi i Komisionit për Ankesa dhe Shpërblime i të paditurës numër 274-KA-D/2014 i datës 26.11.2014, me të cilët vendime paditësit i është shqiptuar masa disiplinore “Degradim” nga grada Rreshter në pozitën Zyrtar Policor, janë anuluar dhe janë shpall të kundërligjshme. Ndërsa, aktgjykimi C.nr.1/15 i datës 21.01.2017, është bërë i plotfuqishëm, pasi që është vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të

Kosovës Ac.nr.3416/17 i datës 23.09.2020. Andaj, gjykata ia fali besimin e plotë dy aktgjykimeve të lartcekura, si provë me të cilën vërtetohet fakti lidhur me anulimin e vendimeve të të paditurës, me të cilët i është shqiptuar masa disiplinore “Degradim” dhe përmes të cilëve vendime paditësit i është shkaktuar dëm, duke i cenuar pagesën e pagave mujore.

Në vazhdim, në ekspertizën financiare të datës 28.09.2023, punuar nga eksperti financiar F.D. nga Prizreni, në formë të detajuar është pasqyruar periudha kohore që paditësit i është cenuar paga mujore dhe diferenca e pagës që i takon paditësit, në shumën neto dhe bruto. Në këtë drejtim, paditësit i takon shuma totale e pagave neto nga data 18.07.2010 deri më 08.10.2010 në lartësi prej 1,039.61 euro, kontributi pensional për punëdhënësin në shumë prej 56.96 euro, kontributi pensional për punëmarrësin në shumë prej 56.96 euro dhe tatimi në pagë prej 42.54 euro apo pagat bruto në këtë periudhë në shumë prej 1,139.10 euro. Po ashtu, paditësit i takon shuma totale e pagave neto nga data 05.12.2014 deri më 22.10.2020 në lartësi prej 11,846.55 euro, kontributi pensional për punëdhënësin në shumë prej 637.57 euro, kontributi pensional për punëmarrësin në shumë prej 637.57 euro dhe tatimi në pagë prej 267.24 euro apo pagat bruto në këtë periudhë në shumë prej 12,751.36 euro. Andaj, nga kjo që u theksua më lartë, rrjedh se shuma totale e kompensimit të pagave neto që i takon paditësit është në lartësi prej 12,886.16 euro. Ndërsa, eksperti financiar F.D. në deklarin e tij gjatë shqyrtimit kryesor, ka sqaruar në mënyrë konkrete mënyrën e pagesës së kontributeve pensionale për punëdhënësin të paditurën dhe punëtorin- paditësin dhe tatimit në pagë, që këto paraqesin detyrime të punëdhënësit- palës së paditur.

Së këndejmi, gjykata ia fali besimin e plotë ekspertizës financiare të datës 28.09.2023 të ekspertit financiar F.D. dhe deklarin të tij, për shkak se kjo ekspertizë në mënyrë profesionale, të detajuar dhe pa mëdyshje pasqyron periudhën kohore që paditësit i është cenuar paga mujore, për shkak të masës disiplinore dhe shumën e kompensimit që duhet bërë paditësit, në emër të diferencës së pagës së papaguar. Po ashtu, ekspertiza e lartcekur përmban elementet e nevojshme dhe arsye të mjaftueshme, të cilat gjykata i vlerësoi si të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore, ndërsa me rastin e deklarin të ekspertit financiar, gjykata ka kuptuar dhe sqaruar çështjen e pagesës së kontributeve pensionale dhe tatimit në pagë, si dhe mënyrën e pagesës së këtyre detyrimeve.

Kështu, në përputhje me dispozitat ligjore të theksuara më lartë dhe provave të elaboruara, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditësit t’ia bëjë kompensimin e dëmit, përkatësisht kompensimin e diferencës së pagave të papaguara, konform detyrimeve që rrjedhin nga kontrata e punës dhe dispozitat ligjore, në shumën që paditësit do t’i takonte nëse e paditura nuk do t’ia cenonte pagën mujore. Më konkretisht, paditësit R.K. i takon diferenca e pagave neto, për periudhën kohore nga data 18.07.2010 deri më 08.10.2010 në shumën prej 1,039.61 euro dhe për periudhën kohore nga data 05.12.2014 deri më 22.10.2020 në shumën prej 11,846.55 euro apo shuma e përgjithshme prej 12,886.16 euro, kontributi pensional i punëdhënësit dhe kontributi pensional i të punësuarit, për periudhën kohore nga data 18.07.2010 deri më 08.10.2010 në shumën prej 113.92 euro dhe për periudhën kohore nga data 05.12.2014 deri më 22.10.2020 në shumën prej 1,275.14 euro apo shuma e përgjithshme prej 1,389.06 euro dhe tatimi në pagë, për periudhën kohore nga data 18.07.2010 deri më 08.10.2010 në shumën prej 42.54 euro dhe për periudhën kohore nga data 05.12.2014 deri më 22.10.2020 në shumën prej 267.24 euro apo shuma e përgjithshme prej 309.78 euro. Andaj, gjykata vendosi si në pikën nën I. dhe II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën, që paditësit t’ia paguajë shumat përkatëse.

Në të vërtetë, gjykata vlerësoi se me rastin e pagesës së diferencës së pagave neto në shumën e përgjithshme prej 12,886.16 euro, e paditura ka obligim ligjor në përputhje me dispozitat ligjore të ligjeve tatimore, përkatësisht ligjit për tatimin në të ardhura personale, që paditësit t'ia paguajë kontributet pensionale dhe tatimin në pagë. Pra, vendosja lidhur me këto detyrime në dispozitiv të aktgjykimit, nuk kanë të bëjnë me kërkesën e palës paditëse ose jo, por që një gjë e tillë përbën detyrim ligjor dhe si të tilla nuk hyjnë në kuadër të kërkesëpadisë dhe nuk ndërliken me kërkesëpadinë.

Gjithashtu, gjykata vlerësoi se përpos dëmit material, kompensimit të diferencës së pagave të papaguara, paditësit i takon edhe dëmi jomaterial, që atij i është shkaktuar nga vendimet e të paditurës- Vendimi i Komisionit të Brendshëm Disiplinor i të paditurës numër 854/KBD/214 i datës 30.10.2014 dhe Vendimi i Komisionit për Ankesa dhe Shpërblime i të paditurës numër 274-KA-D/2014 i datës 26.11.2014, të cilat gjykata i ka gjetur si të kundërligjshëm.

Kështu, nga dy vendimet e të paditurës, respektivisht Vendimi i Komisionit të Brendshëm Disiplinor i të paditurës numër 854/KBD/214 i datës 30.10.2014 dhe Vendimi i Komisionit për Ankesa dhe Shpërblime i të paditurës numër 274-KA-D/2014 i datës 26.11.2014, kanë derivuar nga një një procedurë paraprake penale, në të cilën paditësi është liruar, i njëjti ka përjetuar cenim të së drejtës së personalitetit dhe rrjedhimisht dhimbje shpirtërore. Vendimet e lartcekura të të paditurës, janë anuluar dhe janë shpall të kundërligjshme nga vendimet gjyqësore, përkatësisht nga aktgjykimi C.nr.1/15 i datës 21.01.2017 i Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil dhe i ekzekutueshëm më datë 26.10.2020 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.3416/17 i datës 23.09.2020.

Lidhur me këtë çështje, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në rastin nr. 13112/07 Felix Gutu kundër Republikës së Moldavisë, kishte vendosur që të dëmtuarit F.G., shteti i Moldavisë t'i kompensojë dëmin jomaterial në shumë prej 3,600.00 euro. Kjo pasi që gjykata kishte gjetur se shteti i Moldavisë kishte cenuar parimin e prezumimit të pafajësisë për shkak të dyshimit se i dëmtuari kishte kryer vepër penale dhe si pasojë e kësaj kishte pushuar nga puna të dëmtuarin.

Sipas nenit 199 dhe 200 të LMD-së, shprehimisht përcaktohet e drejta e shpërblimit të dëmit jomaterial, në rast shkeljes të së drejtës së personit dhe për dhimbjet e pësuar shpirtërore, për shkak të shkeljes së nderit. Kështu, në ekspertizën psikiatrike të datës 10.01.2024, punuar nga eksperti psikiatër Dr. N.F. pasqyrohet në mënyrë shumë të detajuar dhimbja shpirtërore që paditësi ka përjetuar, nga e gjithë procedura e zhvilluar lidhur me procedurën disiplinore, përkatësisht masën disiplinore të shqiptuar, e cila është anuluar sipas aktgjykimit të lartcekur. Më konkretisht, nga ekspertiza psikiatrike rezulton se paditësi ka përjetuar dhimbje shpirtërore të intensitetit të lartë, dhimbje shpirtërore të intensitetit të mesëm dhe dhimbje shpirtërore të intensitetit të ulët.

Andaj, gjykata ia fali plotësisht besimin ekspertizës psikiatrike të datës 10.01.2024 të ekspertit psikiatër Dr. Naim Fanaj dhe deklaramit të tij, për shkak se nga kjo ekspertizë në mënyrë profesionale, konkrete dhe tejet përshkruese pasqyrohet dëmi moral, përkatësisht dhimbjet shpirtërore dhe intensiteti i tyre që paditësi ka përjetuar, nga vendimet e të paditurës dhe procedura e ndjekur lidhur me atë çështje. Ndërsa, nga deklarimi i ekspertit të psikiatrisë gjatë shqyrtimit kryesor, gjykata vërtetoi faktin se ka raste të ndryshme në praktikë, por njihet dhe përcaktohet edhe në teori profesionale, kur paraqitet situata që një person të pësojë dhe përjetojë dhimbje shpirtërore, si pasojë e një vendimi të kundërligjshëm të marrë ndaj tij dhe përjetimi i këtyre dhimbjeve mund të zgjasë derisa të rivendoset e drejta e atij personi.

Mbi këtë bazë, gjykata gjeti dhe vlerësoi se paditësit i takon e drejta e kompensimit të dëmit jomaterial në të holla dhe se shuma e gjykuar në lartësi prej 10,000.00 euro është adekuate dhe e drejtë, kjo duke u bazuar në dhimbjet shpirtërore që paditësi ka përjetuar nga vendimet e kundërligjshme të të paditurës, përkatësisht nga procedura e zhvilluar ndaj tij, të cilat kanë sjellë nxjerrjen e atyre vendimeve. Më konkretisht, me rastin e vendosjes së gjykimit të dëmit jomaterial dhe lartësisë së tij, gjykata ka pas parasysh rëndësinë e shkeljes të së mirës- nderit dhe personalitetit të paditësit dhe se ky kompensim i shërben kompensimit dhe zvogëlimit të dhimbjeve shpirtërore që paditësi ka përjetuar, në formë të satisfaksionit.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Në anën tjetër, sa i përket pjesës refuzuese, respektivisht të shumës prej 25,000.00 euro sikurse në pikën nën IV. të dispozitivit të këtij aktgjykimi e deri në shumën e kërkuar për dhimbjet shpirtërore dhe cenimit të nderit e personalitetit, është e pabazuar, pasi që gjykata vlerësoi se shumatat e gjykuara janë të përshtatshme dhe në përputhje me natyrën dhe nivelin e dhimbjeve shpirtërore që paditësi ka pësuar. Andaj, duke i marrë për bazë këto, gjykata ka vendosur që kërkesëpadinë e paditësit përmbi shumatat e aprovuara, ta refuzoj si të pabazuar, pasi që qëllimi i kompensimit të dëmit është t'i mundësojë paditësit satisfaksion që ai të jetë në gjendje t'i kompensojë të mirat jo materiale nga të cilat është privuar nga procedura e ndjekur dhe vendimet e kundërligjshme të të paditurës ndaj paditësit. Gjithashtu, gjykata ka vlerësuar se çfarëdo shume më e lartë sesa ajo e gjykuar në dispozitiv të aktgjykimit, në emër të dëmit jomaterial, do të shkonte përshtat synimeve dhe qëllimeve që nuk janë në pajtim me natyrën e këtij kompensimi dhe me qëllimin shoqëror të tij.

Gjykata vlerësoi pretendimin e të paditurës dhënë në përgjigje në padi se paditësi nuk ka dorëzuar padinë dhe provat në kopje të mjaftueshme siç parashihet me ligj, mirëpo gjeti se një pretendim i tillë është tërësisht i pabazuar. Në të vërtetë, sipas konstatimit që ekziston në shkresat e lëndës më datë 01.03.2023, rezulton se palës së paditur i është dërguar padi së bashku me provat, në mënyrë që e njëjta të përgjigjet në padinë e paditësit.

Gjykata ka bërë vlerësimin edhe të provave të tjera të administruara dhe të përmendura më lartë, por vlerësoi se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen meritorie ndryshe të kësaj çështje juridike.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën nën III. të dispozitivit të aktgjykimit, është marrë konform nenit 449 dhe 452 par. 1 lidhur me nenin 463 par. 1 të LPK-së dhe Tarifën e Odës së Avokatëve, duke obliguar të paditurën, që t'ia paguaj shpenzimet e procedurës paditësit, në shumë të përgjithshme prej 1,180.00 euro. Kështu, shuma e përgjithshme e shpenzimeve ka të bëjë me përpilimin e padisë në shumë prej 156.00 euro, përfaqësimin në seancë gjyqësore në shumë prej 208.00 euro (për tre seanca shuma prej 624.00 euro), dy ekspertizat në shumë prej 300.00 euro dhe për taksën gjyqësore në shumën prej 100.00 euro.

Duke u bazuar në arsyet dhe faktet e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në përputhje me dispozitat ligjore të theksuara në arsyetim të aktgjykimit dhe nenin 143 të LPK-së.

Numri i lëndës: 2020:165304
Datë: 18.03.2024
Numri i dokumentit: 05466734

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.1692/2020 më datë 18.03.2024

Gjyqtari
Uran Zogaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.